



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 12 nëntor 2018, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019” *në parim*.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Z. Ditmir Bushati, Minister për Europen dhe Punët e Jashtme si dhe përqësues të Ministrisë së Financave

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2019.

Projektbuxheti për vitin 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe **procesin e integrimit në Bashkimin Europian.**

Projektbuxheti 2019 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. **Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore,** së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Në shpenzimet e personelit për vitin 2019, planifikohet kostoja e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë si dhe akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për zbatimin e kësaj reforme. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2019 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integrimit europian.**

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2019 vazhdon të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2019, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të strukturave të tjera të administratës publike shqiptare që do të angazhohen në procesin “screening”.

2. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2018-2020

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2018-2020, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së

- Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Nenet 313-316 dhe 320-324.

Legjislacioni dytësor i BE-së

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012”¹.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja e BE-së 2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

4. Përfundime

¹ Rregullorja e BE-së Nr 966/2012 është shfuqizuar me efekt nga data 2 Gusht 2018, por disa nene të saj do të zbatohen deri në datën 31 Dhjetor 2018 (nenet 281, pika 1 dhe 282, pika 3, shkronja “c” të Rregullores 2018/1046).

1107

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

NËNKRYETAR

BLEDAR ÇUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 22 nëntor 2018, në cilësinë e Komisionit që jep mendim mori në shqyrtim projektligjin **“Për Buxhetin e vitit 2019” nen për nen.**

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji *“Për buxhetin e vitit 2019”* parashton tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2019.

Projektbuxheti për vitin 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe **procesin e integrimit në Bashkimin Europian.**

Projektbuxheti 2019 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. **Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore,** së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Në shpenzimet e personelit për vitin 2019, planifikohet kostoja e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë si dhe akomodimi i institucioneve të reja të krijuara për zbatimin e kësaj reforme. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2019 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integrimit europian.**

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2019 vazhdon të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, **projektbuxheti i vitit 2019, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të strukturave të tjera të administratës publike shqiptare që do të angazhohen në procesin “screening”.**

2. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2018-2020

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2018-2020, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së

- Traktati mbi Funkionimin e Bashkimit Europian (TFBE); Nenet 313-316 dhe 320-324.

Legjislacioni dytësor i BE-së

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “*Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012*”¹.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja e BE-së 2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

4. Përfundime


¹ Rregullorja e BE-se Nr 966/2012 është shfuqizuar me efekt nga data 2 Gusht 2018, por disa nene të saj do të zbatohen deri në datën 31 Dhjetor 2018 (nenet 281, pika 1 dhe 282, pika 3, shkronja “c” të Rregullores 2018/1046).

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” nuk përafron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Gjatë shqyrtimit në parim, deputete e komisionit të integrimit evropian, i kërkuan Ministrisë për Europen dhe Punët e Jashtme për nevojat e saj në lidhje me procesin e integrimit evropian e cila, pasi paraqiti buxhetin për procesin e integrimit, nuk parashtroi kërkesa të veçanta në lidhje ndryshime të mëtejshme të buxhetit të vitit 2019 .

Në mbledhjen e shqyrtimit nen për nen, duke konsideruar mjaftueshmërinë buxhetore për mbështetjen e procesit të integrimit evropian, Komisioni miratoi **nen për nen** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

NËNKRYETAR

BLEDAR ÇUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më 05.11.2018

RAPORT

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2019”
(Shqyrtimi në parim)**

Hyrje

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 05.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019”, me cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: Z. Pandeli Majko, Ministër i Shtetit për Diasporën, Z. Dritan Delija, Drejtor i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Znj. Soana Jaupllari, Drejtore e Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, Z. Gentian Opre, Drejtor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Znj. Ina Dhaskali, Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të veçantë shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

Projektbuxheti 2019 parashikon:

Të ardhurat	486 477	milione lekë;
Shpenzimet	519 377	milione lekë;
Deficiti	32 900	milione lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	15 500	milione lekë;
Të ardhurat tatimore	325 604	milione lekë;
Të ardhurat jotatimore	23 840	milione lekë.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.3% në vitin 2019. Norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 12% në 2019, dhe pritet të gjenerohen mbi 30 mijë vende të reja pune.

Rritja e parashikuar për çdo vit është 4.2% për vitin 2018; 4.3% për vitin 2019; 4.4% në vitin 2020.

Deficiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet në nivelin 1.9% të PBB, që është niveli më i ulët i targetuar në ligjin vjetor të buxhetit në dy dekadat e fundit.

Projektbuxheti 2019, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Në tre vitet e fundit, buxhetet e miratuara kanë synuar reduktimin gradual dhe të targetuar të barrës tatimore nëpërmjet uljes së tarifave të tatimit dhe përjashtimeve të studiuara. Rritja e të ardhurave është synuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor. Edhe Projektbuxheti i vitit 2019 synon të

1143
shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2019-2021 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe veçanërisht për këtë vit mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Ri-jetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, programi *100 Fshatrat* do të synoj të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndër-sektoriale dhe me shumë aktorë. Programi konsiston në konsolidimin e investimeve publike, atyre të donatorëve dhe i investimeve private, në hapësirën e 100 fshatrave, me potenciale të larta zhvillimi ekonomiko-sociale, të agro-turizmit e turizmit rural, natyrës dhe mjedisit, si dhe të trashëgimisë kulturore.

Projektbuxheti 2019 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për **thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë**. Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2019, do të jetë rreth 11 përqind më i lartë se ai i 2018-ës ose 5 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike. Transferata e pakushtëzuar e përgjithshme e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë 1 përqind e PBB-së ose 1 miliard lekë më e madhe se sa ajo e vitit 2018 dhe 5.2 miliard lekë më e lartë se transferata e vitit 2015. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat në vitin 2019 do të jenë 22.6 miliard lekë ose 21 përqind më të larta se në vitin 2018. Të ardhurat e veta të njësitë të vetëqeverisjes vendore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2015, si viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale, janë dy herë më të larta, 10 miliard lekë më shumë. Buxheti për vitin 2019 do të jetë 2.92 përqind e PBB-së, dhe krahasuar me vitin 2015 rezulton me një rritje të ndjeshme me rreth 50 përqind.

Me buxhetin e vitit 2019, konsolidohet transferimi i plotë pranë bashkive i funksioneve të decentralizuara në vitin 2016 me Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, dhe bashkë me to mbështetja financiare për periudhën tranzitore prej 3 vitesh. Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2019, për të tretin vit radhazi, krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetaret (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të transferuara në 2016) dhe njëkohësisht për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër administrativo territoriale.

Buxheti vendor i vitit 2019, parashikohet të jetë rreth 11 përqind më i lartë se ai i vitit 2018, ose në nivelin prej 2.92 përqind e PBB-së. Krahasuar me vitin 2015 me një rritje të ndjeshme me rreth 50 përqind. Me buxhetin e vitit 2019, do të financohen funksionet e transferuara në 61 bashkitë, dhe të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në ligj, të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë t'i ushtrojnë në shërbim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Projektbuxheti i vitit 2019 mbështet reformat në këta sektorë kyç:

- Reforma në administratën publike

Reforma në administratën publike në Shqipëri vijon të jetë një proces i rëndësishëm dhe kyç, i lidhur ngushtë me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian (BE) si dhe një nga parakushtet kryesore për një qeverisje transparente dhe efektive. Një administratë publike funksionale tregon aftësinë e qeverisë për t'ju përgjigjur nevojës për përmirësimin e shërbimeve publike të ofruara për qytetarët dhe biznesin, rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë dhe për të ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të vendit.

Prioritetet për vitin 2019 janë :

- Zbatimi i Planit të Ri të Veprimit të SNRAP dhe aktiviteteve për periudhën 2018-2020, i cili synon fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit ndaj publikut;
- Zbatimi i projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, i cili ka nisur më datë 9 tetor 2018 dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 30 muajsh. Projekti ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të qeverisjes së sektorit publik dhe efikasitetin e Administratës Publike Shqiptare;
- Vijimin e zbatimit të programit për Administratën që duam, një program i qeverisë shqiptare për energjizimin e administratës publike nëpërmjet orientimit të përpjekjeve të administratës drejt prioriteteve dhe vizionit qeverisës, rritjes së aftësive dhe kapaciteteve profesionale të nëpunësve publikë, motivimit dhe angazhimit të tyre si dhe rritjes së ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional;
- Puna për zhvillimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) dhe finalizimi i bashkërendimit midis HRMIS dhe sistemit të thesarit;
- Projekti nën IPA 2015 “Profesionistë të rinj për Shqipërinë” do të jetë në formën e një granti, ku objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti do të jetë rritja e kapacitetit dhe ekspertizës së nëpunësve civilë në sektorët kryesorë në përputhje me prioritetet e Qeverisë dhe me kërkesat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

- Reforma e menaxhimit të financave publike

“Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për periudhën 2014-2020” është një dokument, i cili reflekton angazhimin e Qeverisë Shqiptare ndaj qytetarëve për zbatimin e një sërë reformave të rëndësishme për mirë menaxhimin e financave publike. Gjatë gjysmë së dytë të vitit 2018 u ndërmor rishikimi dhe vlerësimi afatmesëm i Strategjisë, për përcaktimin e prioriteteve për periudhën 2018-2022.

Për vitin 2019, synohet progres i mëtejshëm në realizimin e objektivave të cilat janë pjesë e shtyllave të strategjisë si:

- Të nisë zbatimi i Strategjisë së Rishikuar të MFP-së dhe Planit të Veprimit 2018-2022.

- Të bëhen funksionale sistemet AFMIS dhe IPSIS dhe të realizohet integrimi i këtyre sistemeve dhe EAMIS. Trajnim i stafit që do të përdorë sistemet.
- Të bëhet funksional sistemi për kadastrën fiskale. Ky sistem do të shërbejë për të përmirësuar administrimin dhe performancën e taksimit të pasurisë si dhe krijimin e bazës së nevojshme për të kaluar në një metodologji moderne llogaritje të taksës kalimin në sistemin e taksimit ku baza e taksës të jete vlera e pronës.
- Forcimi i kapaciteteve të Institutit të Statistikave në fushën e llogarive kombëtare të qeverisë duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së të dhënave të nevojshme të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ) dhe transmetimin e tabelave të reja me të dhënat e SFQ-së në EUROSTAT sipas kërkesave të Standarteve Evropiane të Kontabilitetit 2010.
- Zbatimi i udhëzimit të ri standard për përgatitjen e PBA-së duke synuar forcimin e rolit udhëheqës të dokumentit të PBA-së dhe cilësinë e procesit strategjik të përgatitjes së buxhetit; përmirësimin dhe asistimin në përgatitjen e metodologjive të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor; si dhe pilotimin e metodologjive të avancuara të PBA-së dhe të buxhetimit në Ministrinë e Linjës të përzgjedhura; Asistimi i Ministrive të Linjës në zbatimin e qasjes së rishikuar të përgatitjes së buxhetit gjatë ciklit të përgatitjes së buxhetit.
- Paraqitja e pasqyrave financiare në përputhje me standardet e përzgjedhura të IPSAS.
- Zhvillimi i një kualifikimi të qëndrueshëm të kontabilitetit në sektorin publik në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare si dhe përmirësimin e mirëkuptimit dhe zbatimit të standardeve përkatëse të kontabilitetit nga praktikuesit dhe auditorët e sektorit publik.
- Rritja e kapaciteteve të inspektorëve të jashtëm nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Përgatitja e një dokumenti gjithëpërfshirës strategjik mbi politikën e kontrollit të brendshëm duke u fokusuar në zbatimin e një sistemi efikas të llogaridhënies së menaxhimit në njësitë publike si dhe përgatitja e një udhëzimi specifik për delegimin e detyrave të menaxherëve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
- Rritja e bashkëpunimit të KLSH-së përmes Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

- Reforma për arsimin parashkollor

Buxheti i vitit 2019, shënon fillimin e një reforme të rëndësishme që vendos një standard të ri në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, fondet për arsimin parashkollor do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të nxënësve, si treguesi më i mirë i nevojës për fonde dhe shërbime, dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në vitin 2018.

1146

Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69 datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe praktikat e mira ndërkombëtare që rekomandojnë në një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç).

Për sa më sipër, në buxhetin e vitit 2019, fondet e pagave për edukatorët do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve. Kjo reformë siguron një ndarje më të përshtatshme të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të sistemit aktual.

Kjo reformë synon dhe siguron:

- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale dhe të menjëhershme për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 23 fëmijë për një edukatore në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.
- Ruajtjen e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve, zbut diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit "fëmijë për edukatore" dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

- Reforma në drejtësi

Reforma në drejtësi ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

Objektivat afat mesëm dhe afat gjatë të Reformës në Drejtësi janë si më poshtë:

- Forcimi i statusit të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve, përfshirë ndihmësmagjistratët /këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë.

- 114
- Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane.
 - Rritja e funksionimit të KLGJ dhe zgjerimi i objektit të kompetencave të tij, duke i bërë gjykatat më të larta pjesë të objektit të saj dhe duke zgjeruar funksionet, p.sh. në lidhje me IT, buxhetin gjyqësor, administrimin e gjykatave, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare.
 - Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve në bazë të standardeve moderne evropiane dhe zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore.
 - Krijimi i një strukture të specializuar antikorrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.
- Reforma në sektorin e ujit synon:
 - Mirë administrimin e burimeve ujore
 - Rritjen e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në vlerën 2-3%
 - Rritjen e numrit të orëve të shërbimit
 - Reduktimin e humbjeve fizike në rrjet
 - Rikuperimin e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes
 - Qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve
 - Ekzistencën e tarifave të drejta kundrejt shërbimit

Të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 2019

Të ardhurat nga "T.V.SH-ja" parashikohet të jenë 153.3 miliardë lekë, 9.5 miliardë lekë më shumë se pritshmëria për vitin 2018, ose 6.6%. Burimet e rritjes së TVSH-se në vitin 2019 do të jenë:

- TVSH që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve;
- TVSH nga rritja e volumit të importeve dhe konjunktura e çmimeve ndërkombëtare;
- TVSH nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve.

Të ardhurat nga "Tatimi mbi Fitimin" vlerësohen me rritje 7% ose 2.2 miliardë lekë më shumë se viti 2018, pra parashikohet të arketohen 33.5 miliardë lekë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet:

- në rritjen ekonomike të parashikuar, çka do reflektohet edhe në deklaratat e tatimpaguesve;
- në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;
- në kontributet fiskale që do të gjenerohen nga sektori energjitik (OSHEE, KESH) të cilat në vitin 2018 paraqiten me një situatë të përmirësuar krahasuar me vitin 2017, çka do të reflektohet edhe në bilancet e tyre financiare. Theksojmë se performanca në tatimin mbi fitimin e vitit 2018 dhe rritja relativisht e ulët krahasuar me vitin 2017, lidhet me situatën

energjitike që kaloi vendi në vitin 2018, e cila u reflektua në bilancet dhe kontributet fiskale të kompanive në vitin 2018.

Të ardhurat nga “Akciza” vlerësohen të jenë 48.3 miliardë lekë, me një rritje prej 2.8 miliardë lekë ose 6.2% më shumë se pritshmëritë për vitin 2018. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza janë:

- programimi i rritjes me 200 ton cigare krahasuar me të pritshmin 2018;
- rritja me 4% e importit/prodhimit të karburanteve;
- rritja e akcizës së cigareve me 3 lekë/paketa me efekt 0.46 miliardë lekë;
- rritja e të ardhurave nga akciza e duhanit dhe zëvendësuesve të tjerë 0.22 miliardë lekë;
- lufta kundër informalitetit, kontrolli rigoroz i subjekteve të akcizës si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” parashikohen 43.4 miliardë lekë, me rritje +16% ose +6 miliardë lekë më shumë se viti 2018. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë:

- rritja ekonomike dhe impakti i saj në nivelin e pagës mesatare;
- rritja e numrit të të punësuarve, bazuar në ecurinë e vitit 2018;
- uljen e të ardhurave nga rritja e pragut të taksimit të pagave me tarifën 23%, që vlerësohet në -320 milionë lekë në vit.
- uljen e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, përfshirë efektet pozitive që do gjenerohen nga incentiva për shpërndarjen e fitimeve të akumuluarra të viteve të kaluara, që vlerësohet në 4.5 miliardë lekë.

Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” vlerësohen të jenë 39.7 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2019 janë -1% ose 0.4 miliardë lekë më pak se i pritshmi 2018 dhe bazohen në:

- efektet e rritjes ekonomike;
- efektet nga mbyllja e lojërave të fatit e llogaritur në -4 miliardë lekë;
- efektet e ndryshimeve në taksën e ambalazheve plastike dhe taksën e rentës me rreth +0.5 miliardë lekë;

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” në vitin 2019 vlerësohet të jenë 7.4 miliardë lekë, me rritje 390 milionë lekë ose 5.6% krahasuar me vitin 2018, realizimi i pritshëm i të cilit parashikohet të jetë 7 miliardë lekë. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme, si dhe disa efekte minimale nga lëvizja e tarifave doganore.

Të ardhurat nga “Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore” në vitin 2019 parashikohet të rriten me +7%, ose +6.4 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2018. Të ardhurat nga

1148

kontributet pritet të jenë 97.9 miliardë lekë, nga 91.5 miliardë lekë që do arkëtohen në vitin 2018. Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike çka do reflektohet në rritjen e numrit të punësuarve;
- forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;
- ritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet në dy-tre vitet e fundit;
- efektin për rreth 1 miliardë lekë nga rritja e pagës minimale nga 24 mijë lekë në 25 mijë lekë, duke filluar nga 1 janari 2019.

Shpenzime publike për vitin 2019 janë planifikuar 519.4 miliardë lekë ose 29.6% e PBB.

Defiçiti buxhetor

Defiçiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet të jetë në nivelin 1.9% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të katërtin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.5% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënese për të katërtin vit rradhazi. Rrjedhimisht targetohet që niveli i “borxhit publik neto nga asetet likuide në TSA” do të ulet me rreth 2 pikë përqindje [në 64.9% të PBB] dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Financimi i defiçitit do të realizohet nëpërmjet burimeve huamarrjes së brendshme në rreth 1.3% të PBB, huamarrjes së huaj në rreth -0.9% të PBB, si dhe nëpërmjet përdorimit të gjendjes së depozitës në TSA të akumuluar gjatë vitit 2018 (kryesisht nga emetimi i Eurobondit) prej rreth 1.5% e PBB.

Planifikimi buxhetor i Ministrisë së Shtetit për Diasporën

Në parashikimin e buxhetit 2019 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore është parashikuar “Shërbimi për diasporën” me këto shpenzime:

Totali i shpenzimeve korrente: 47 milionë lekë

Financim i brendshëm: 36 milionë lekë

Financim i huaj: 0

Totali i Shpenzimeve Kapitale: 36 milionë lekë

Totali i shpenzimeve buxhetore: 83 milionë lekë

Z. Majko shpjegoi në prezantimin e projektligjit se buxheti i tij është i përfshirë në Buxhetin e Kryeministrisë, dhe se planifikimi i buxhetit bëhet në kuadër të krijimit dhe zhvillimit të agjensive përkatëse. Në zbatim të ligjit Nr 16/2018 “Për Diasporën”, qeveria ka ngritur një sërë aktesh nënligjore për zbatimin e parashikimeve në ligj. Ndër to, është Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve për diasporën”, e cila në projektbuxhetin e vitit 2019 është planifikuar të ketë 13 punonjës. Gjithashtu zë i parashikuar në buxhet është dhe Agjensia për Diasporën, dhe Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Diskutime në Komision

Pas prezantimeve të objektivave që kërkon të realizojë Ministri i Shtetit për Diasporën, bazuar në buxhetin e planifikuar për këtë vit, nga Ministri Z. Majko, deputetët kërkuar sqarime rreth planifikimit buxhetor për këtë ministri.

Deputetët, duke e konsideruar çështjen e diasporës si çështje e një rëndësie kombëtare u shprehën të gatshëm për të mbështetur nevojat e planifikuara në projektbuxhetin për vitin 2019.

Në përfundim, nga studimi i projektligjit dhe relacionit shpjegues vërehet se:

Relacioni shoqërues i projektligjit shpjegon në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre. Projektbuxheti i Ministrisë së Shtetit për Diasporën, **në parim i plotëson nevojat** në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2019.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Pas diskutimeve në komision, **deputetët votuan në parim** buxhetin në tërësi dhe buxhetin për Ministrinë e Shtetit për Diasporën.

Raporti i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2019”.

RELATORE

Evis KUSHI

KRYETARE

Mimi KODHELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më 06.11.2018

RAPORT

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2019”
(Shqyrtimi në parim për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme)**

Hyrje

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 06.11.2018, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: Z. Ditmir Bushati, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Ilda Dega, Drejtoreshë e Financës, Z. Gentian Opre, Drejtor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Znj. Ina Dhaskali, Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave.

Baza Kushtetuese e projektligjit

Projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të veçantë shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

Planifikimi buxhetor i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Projekt buxheti i vitit 2019 për MEPJ, është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2020, krahasuar me buxhetin e vitit 2018, parashikohet të jetë me një rritje në vlerë absolute 83.3 milionë lekë. Në raport PBB buxheti i MEPJ është në nivelin e 0.76 %.

Për sa i përket organikës së institucionit, gjatë vitit 2019 numri i punonjësve nuk do të ndryshojë, pra është i njëjtë me atë të këtij viti. Institucioni i MEPJ do të ketë 551 punonjës, nga të cilët 356 punonjës në misione diplomatike dhe poste konsullore jashtë vendit dhe 195 punonjës në Ministri.

Projekt-buxheti i vitit 2019 siguron kapacitetet e nevojshme financiare që mundësojnë mbështetjen e aktiviteteve dhe objektivave të orientuara nga prioritetet e politikës së jashtme të Shqipërisë.

Diskutime në Komision

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Ditmir Bushati, në paraqitjen e tij, tha se buxheti që kërkon Ministria për vitin 2019 parashikohet të jetë 3% në rritje në raport me buxhetin e vitit 2018.

Buxheti synon realizimin e prioriteteve që ne kemi për 2019, e më konkretisht:

- Hapjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duke mbështetur strukturat e administratës publike që do të angazhohen në procesin e “screening”.
- Zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me prioritet partneritetin strategjik.
- Vazhdimin e angazhimeve për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës për pjesëmarrje dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.
- Funkcionalizimin dhe mbështetjen e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor si dhe në tërësi pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale.
- Kryesimin e radhës së OSBE-së në vitin 2020 dhe në disa organizma ndërkombëtare.
- Pjesëmarrjen aktive dhe dhënien e kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATOs.
- Zbatimin e detyrimeve të anëtarësimin në organizata dhe forume shumëpalëshe.
- Plotësimin e bazës ligjore të bashkëpunimit me vendet e tjera.
- Forcimin dhe rritjen e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialit për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumë palësh.
- Përsosjen e shërbimit konsullor, mbështetur në profesionalizëm, transparencë dhe përgjegjshmëri.
- Rritjen e pagës së personelit të përfaqësive tona diplomatike jashtë shtetit etj.

Relatori, Z. Ervin Bushati duke u shprehur se projektbuxheti i vitit 2019 është i arsyeshëm dhe justifikon plotësisht qëllimin e tij ftoi Komisionin ta miratoje atë.

Pas prezantimit, deputetët kërkuan sqarime rreth planifikimit buxhetor për këtë ministri. Gjatë diskutimeve, deputetët vlerësuan dinamikën e procesit për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dhe u siguruan që ky planifikim mbështet nevojat për mbarëvajtjen e këtij procesi. Deputetët u interesuan për përkthimin e objektivave në shifra si dhe për masat e marra në kuadrin buxhetor në rastin e hapjes së negociatave.

Ministri Bushati theksoi si një nga objektivat e pritshme të planifikuara në projektbuxhetin 2019, edhe marrjen nga Shqipëria të kryesimit të OSBE-së i cili do të jetë një angazhim shumë i madh, i vështirë dhe sfidues për strukturat e kësaj ministrie.

Pas diskutimeve, komenteve dhe sugjerimeve buxheti 2019 u miratua në parim.

Në përfundim, nga studimi i projektligjit dhe relacionit shpjegues vërehet se:

Relacioni shoqëruar i projektligjit shpjegon në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre. Projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, **në parim i plotëson nevojat** në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2019.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Pas diskutimesh në komision, **deputetët votuan në parim** buxhetin për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Raporti i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2019”.

RELATOR

Ervin BUSHATI

KRYETARE

Mimi KODHELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më 23.11.2018

RAPORT

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR BUXHETIN E SHETIT TË VITIT 2019”
(Shqyrtimi nen për nen)**

Hyrje

Komisioni për Politikën e Jashtme mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” me cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e buxhetit dhe paketës fiskale për vitin 2019 dhe në nenet 32-38 dhe 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, drejtuesi i Agjensisë Kombëtare për Diasporën dhe drejtuesi i Fondit për Zhvillimin e Diasporës me cilësinë e institucioneve në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme ishin të pranishëm: z. Gazmend Barbullushi, Sekretar i Përgjithshëm dhe stafi mbështetës.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 158 të Kushtetutës.

Parashikimet buxhetore sipas projekt Buxhetit të Shtetit 2019

Shqyrtimi i projektligjit “Për Buxhetin e Shtetit 2019”, në Komisionin për Politikën e Jashtme u fokusua në evidentimin dhe shqyrtimin e parashikimeve buxhetore për vitin 2019 për institucionet në fushën e mbulimit të këtij komisioni, konkretisht Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe strukturat e tij ndihmëse, si dhe për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Projektbuxheti i Ministrisë të Shtetit për Diasporën

Misioni i ministrit të Shtetit për Diasporën, është të përfaqësojë e të nxisë politikat e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me Shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

Buxheti i Ministrisë të Shtetit për Diasporën është përfshirë në buxhetin e kryeministrit, kështu që në aneks-buxhetin e vitit 2019 janë parashikuar fonde për institucionet në varësi të Ministrisë të Shtetit për Diasporën, të cilat do të mbështesin misionin e Ministrisë duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çëshjet që lidhen me Diasporën si dhe me zhvillimin e Samitit të Diasporës.

Për sa i takon Agjencisë Kombëtare për Diasporën, krijuar me Ligjin nr 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, ajo ka si qëllim nxitjen dhe zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen në jetën kulturore, social – ekonomike dhe politike në Diasporë si dhe synon zbatimin e politikave shtetërore dhe krijimin e instrumentave të dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të fuqizuar bashkëpunimin me diasporën.

Ndërsa Qendra e Botimeve për Diasporën, krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve për Diasporën”, realizon një sërë funksionesh sa i takon botimit, krijimit të aksesit, bashkrendimit të punës apo koordinimin me institucionet sa i takon teksteve dhe botimeve për Diasporën.

Në projektbuxhetin e vitit 2019, për Ministrinë e Shtetit për Diasporën, janë parashikuar këto zëra:

Shërbimi për diasporën:

Totali i shpenzimeve korrente:	47 milion lekë
Financim i brendshëm:	36 milion lekë
Total i shpenzimeve kapitale:	36 milion lekë
Totali i shpenzimeve buxhetore:	83 milion lekë

Numri i punonjësve që është parashikuar për institucionet është :

Agjencia për diasporën:	15 punonjës
Qendra e Botimeve për Diasporën:	13 punonjës

Projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2019

Projekt buxheti i vitit 2019 për MEPJ, është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2020, i cili krahasuar me buxhetin e vitit 2018, parashikohet të ketë një rritje në vlerë absolute 83.3 milionë lekë ose rreth 3%. Në raport PBB buxheti i MEPJ është në nivelin e 0.76 %.

Për sa i përket organikës së institucionit, gjatë vitit 2019 numri i punonjësve nuk do të ndryshojë, pra është i njëjtë me atë të këtij viti. Institucioni i MEPJ do të jetë me 551 punonjës, nga të cilët 356 janë punonjës në misione diplomatike dhe poste konsullore jashtë vendit dhe 195 janë punonjës në ministri.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2019 mundëson kapacitetet e nevojshme të mbështetjes financiare, me qëllim përmbylljen e reformave të nisura gjatë viteve të mëparshme dhe realizimin e objektivave të reja, si:

- Hapjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duke mbështetur strukturat e administratës publike që do të angazhohen në procesin e “screening”.
- Zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me prioritet partneritetin strategjik.
- Vazhdimin e angazhimeve për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës për pjesëmarrje dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.
- Funksionalizimin dhe mbështetjen e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor si dhe në tërësi pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale.
- Kryesimin e disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.
- Pjesëmarrjen aktive dhe realizimin e kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s.
- Zbatimin e detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe.
- Plotësimin e bazës ligjore të bashkëpunimit me vendet e tjera.
- Forcimin dhe rritjen e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialit për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumë palësh.
- Realizimin e shërbimit konsullor mbështetur në profesionalizëm, transparencë dhe përgjegjshmëri.

Diskutime në Komision

Ministri i shtetit për diasporën duke e vlerësuar në përgjithësi projektbuxhetin e vitit 2019, së bashku me përfaqësuesit e institucioneve të varësisë, shprehën përpara komisionit edhe disa kërkesa për shtesa dhe ndryshime në projektbuxhetin për vitin 2019, me arësyetimin se paraqitja e institucioneve të pavarura të Diasporës në një program të vetëm është në kundërshtim me legjislacionin e miratuar, konkretisht ligjin nr. 16 datë 05.04.2018, “Për Diasporën”, ligjin nr. 115 datë 18.12.2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, ligjin nr. 32 datë 07.06.2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Për këtë arsye Ministri i Shtetit për Diasporën kërkoi paraqitjen e këtyre institucioneve të pavarura në buxhet si zëra më vete, dhe shtesat si më poshtë:

- Për *Agjensinë Kombëtare të Diasporës*, shtimin e buxhetit me 53.500.000 lekë, nga 26.500.000 lekë të parashikuara në projektbuxhetin për vitin 2019, të ndara sipas tabelës:

Zëri	2019
Shpenzime për paga	16.500.000
Shpenzime korrente	63.500.000
Totali	80.000.000

- Për *Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën*, në zbatim të programi 3 vjeçar të miratuar me VKM nr 611, datë 17.10.2018 “Për Financimin e Projektit `Diaspora për Zhvillim`” Ministri kërkoi shtimin e buxhetit me 14.901.744 lekë, duke e rritur buxhetin në shumën 44.901.844 lekë, të ndara sipas tabelës më poshtë:

Zëri	2019
Shpenzime për paga	10.056.000
Shpenzime korrente	3.792.000
Shpenzime për aktivitete të projektit	21.404.858
Shpenzime ndërgjegjësimit dhe komunikim	5.567.000
Shpenzime të tjera	4.081.986
Totali	44.901.844

- Për *Qendrën e Botimeve për Diasporën*, duke patur parasysh kërkesat në rritje për arsim në Diasporë, u kërkua të shtohet fondi prej 23.500.000 lekë, duke e rritur buxhetin në masën 50.000.000 lekë, të ndara sipas tabelës më poshtë:

Zëri	2019
Shpenzime për paga	15.000.000
Shpenzime korrente	20.000.000
Shpenzime kapitale	15.000.000
Totali	50.000.000

Përfaqësuesit e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, vlerësuar projektbuxhetin e vitit 2019 por theksuan nevojën për disa ndryshime në tavanet buxhetore, si më poshtë:

- Shtesë në vlerën 8 milion lekë në programin buxhetor 1110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
- Shtesë në vlerën 8 milion lekë. në programin buxhetor 1150 “Mbështetja Institucionale për procesin e integritimit”.
- Pakësim në vlerën 16 milion lekë në programin buxhetor 1120 “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”.

Bazuar në kërkesat e sipërcituara anëtarët e Komisionit kërkuan informacion dhe shpjegime mbi arsyet e kërkesave për ndryshime dhe shtesa në projekt-buxhetin për vitin 2019, si dhe mbi realizimet e deri më tanishme të të dyja ministrive në kuadër të shpenzimeve buxhetore. Përfaqësuesit e ministrive dhanë shpjegime të detajuara si dhe mundësuan paraqitjen pranë komisionit të prezantimit të objektivave që pritet të realizohen me projekt-buxhetin për vitin 2019 së bashku me ndryshimet e kërkuara,

Përfundime:

Në përfundim të diskutimeve Komisioni për Politikën e Jashtme vlerësoi se:

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj.
- Relacioni shoqërues i projektligjit shpjegon në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre.
- Për projektbuxhetin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën në Komisioni vlerësoi të drejtë kërkesën për shtesa dhe i miratoi ato duke u shprehur dakord për t’ja kaluar ato komisionit përgjegjës, me kushtin që kërkesa e ministrit të vijë e miratuar nga ministria e financave.
- Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, projektbuxheti i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2019, veç nevojës për disa ndryshime në tavanet buxhetore, të evidentuara më lart.

Për sa më lart Komisioni për Politikën e Jashtme , me shumicë votash **miratoi nen për nen dhe në tërësi** buxhetin për Ministrinë e Shtetit për Diasporën dhe buxhetin për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe projektligjin “Për buxhetin e shtetit 2019”.

Raporti i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2019”.

RELATOR

Evis KUSHI

Ervin BUSHATI

KRYETARE

Mimi KODHELI